



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 168, datë 05.05.2022**

**PËR**

**NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË  
APELIT TË Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 187, datë 28.05.2020, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

**VENDOSI:**

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të z. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 10.05.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Apelit si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**